



Republika e Kosovës


REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 191/15

Nr. i fq. / Br. st - 22 -

Data: / Datum 29.09.2015

VUSHTRRI - VUČITRN





Kuvendi i Komunës- Vushtri

Bazuar në Nenin 12.2 pika (d) të Ligjit 03/L-40 mbi Vetëqeverisje Lokale, Nenin 41.2 pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2015, mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR RINI

1. Me këtë Vendim aprovet Plani i Veprimit për Rini i Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin “Plani i Veprimit për Rini ”.
4. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Strategjinë Kosovare për Rini 2013/2017, në nenin 41, paragrafi 2, pika “d”, të Statutit të Komunës, si dhe në nenin 10, paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, dhe 1.3 Udhëzimin administrativ Nr.9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit Rinor në Kosovë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29.09.2015** miraton:

Planin e Veprimit për Rini

Dokumenti për Politikën Rinore në Komunën e Vushtrrisë, është një akt i organizuar nga Drejtoria Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, Sektori për rini në bashkëpunim të ngushtë me organizatat rinore në Komunën e Vushtrrisë.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti të Politikave Rinore është që
“Të miratohet/aprovohet në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë”.

Pas miratimit/aprovimit të këtij dokumenti, zbatimi i tij në tërësi i takon Kuvendit Komunal/ drejtorive komunale, varësisht prej programeve dhe aktiviteteve /Sektorit për rini, dhe shoqërisë civile/OJQ-ve rinore.

Si i tillë ky dokument i Politikave Rinore i pasuar nga Plani i Veprimit për Rini, pas aprovimit të tij do të ndikonte masë të madhe në jetën e të rinjve, brenda Komunës së Vushtrrisë.

Politikat Rinore dhe Plani i Veprimit për Rini, janë të hartuara konform dokumenteve të cilat ndërlidhen me fushën e rinisë, qoftë në nivelin lokal qoftë në atë qendror, projekti i tillë është bazuar në këto dokumente:

**Ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë,
Udhëzimet administrative nga Ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë,
Strategjinë Kosovare për Rini 2013-2017,
Ligjin për Vetëqeverisje Lokale,
Statutit të Komunës,**

Shkurtesat/përkufizimet

KK- Kuvendi Komunal
DKRS-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
SR-Sektori i rinisë
DK- Drejtoritë Komunale
KVRL- Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
PK-Policia e Kosovës
FSK-Forca e Sigurisë së Kosovës
OJQ-Organizata joqeveritare
QR-Qendrat rinore
RSH- Rinia shkollore
RKK- Rinia e Kryqit të Kuq

Objektivat strategjike sipas Strategjisë Kosovare dhe Planit të Veprimit për Rini 2013-2017

1. Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje,
2. Edukimi joformal,
3. Shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor,
4. Punësimi dhe ndërmarrësia,
5. Siguria njerëzore
6. Kultura, sporti dhe rekreacioni

1. PJESËMARRJA E RINISË NË VENDIMMARRJE

Definicioni: Pjesëmarrje e të rinjve në procesin e vendimmarrjes do të thotë të rinjtë ftohen (përmes DKRS / Sektorit të rinisë) në takime konsultative nga strukturat e ndryshme të Kuvendit Komunal, kur këto struktura duhet të marrin një vendim të drejtpërdrejt sa i përket të rinjve.

Qëllimi: “Përfaqësimi fuqizimi dhe përkrahja e rinisë në politikat vendimmarrëse dhe integrimin e gjithmbarshëm të rinisë”.

Objektiva: Krijimi i mundësisë dhe hapësirave për pjesëmarrje në vendimmarrje i të rinjve.

Planifikimi i aktiviteteve:

- Strukturimi i KVRL-së-zgjedhjet e zakonshme sipas Statutit;
- Organizimi i takimeve të rregullta mujore në mes të organizatave rinore në komunë, me pjesëmarrje dhe monitorim të DKRS/Sektorit të rinisë;
- Sigurimi i qirasë së zyrave të KVRL-së;

- Shpenzime administrative për KVRL-në dhe qendrën rinore;
- Organizatat rinore të krijojnë kontaktet e nevojshme me DKRS/ Sektorin e rinisë dhe organet tjera kryesore të Kuvendit Komunal;
- Organizatat rinore (sidomos KVRL) marrin pjesë dhe kanë mundësi t'i drejtohen Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë e Financa, Bordit të drejtorëve për projektet dhe interesat e tyre rinore;
- Organizatat rinore krijojnë raporte partneriteti me institucionet komunale;
- Kuvendi Komunal, DKRS/Spektori i rinisë ju mundësojnë organizatave rinore që në kuadër të nevojave rinore ata të jenë pjesëmarrës në organet e lartcekura;
- DKRS/Spektori i rinisë obligohet që organizatave rinore t'u ofrojë informacionet, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e nevojshme me qëllim të qasjes në të gjitha aktivitetet e Kuvendit Komunal që kanë të bëjnë me rininë;
- Komuna/drejtoritë komunale mbështesin projektet e të rinjve, sipas projekt-propozimeve të bëra nga organizata në bazë të nevojave dhe në përputhshmëri me Planin e Veprimit për Rini;
- 10 Takime me të rinjtë "Roli i të rinjve në vendimmarrje";
- Përcaktimi i Ditës së Rinisë në Komunën e Vushtrrisë.

2. Edukimi joformal, shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor

Definicioni: Me edukim joformal nënkuptojmë aftësimin e të rinjve për lëmi specifike, të cilat njohuri nuk mund të arrihen nga edukimi formal. Ky edukim do të behët nepërmës metodave trajnuese, në kurse, seminare, ligjërata, tribuna etj.

Qëllimi: Zhvillimi i vetëdijes mes të rinjve lidhur me përgjegjësitë qytetare (edukimi shëndetësor me theks të veçantë në temat për IST, HIV-AIDS, kontracepsion, parandalimi i sjelljeve devijante dhe të rrezikshme, trajnimet profesionale, kurse dhe aktivitete tjera edukativo-shëndetësore).

Vlerësimi i rëndësisë së tyre

Në procesin e rregullt edukativo-arsimor ka mungesë/nuk ofrohen njohuri të mjaftueshme në disa fusha jetësore.

Objektivat:

- Ngritja e vetëdijes tek të rinjtë;
- Promovimi i një rinie të shëndoshë;
- Parandalimi i sjelljeve devijuese;
- Largimi i të rinjve nga proceset negative në shoqëri;
- Rritja e aktiviteteve rinore në këtë plan;
- Respektimi i të drejtave të njeriut (gjinore, fetare, etnike, aftësisë fizike, të drejtat e fëmijëve), etj

Planifikimi i aktiviteve:

- Trajnim për udhëheqje rinore;
- Trajnime për përpilim, koordinim dhe zbatim të projekteve;
- Trajnime për planifikim, monitorim dhe avokim;
- Fushata vetëdijesuese;
- Organizim të debateve me karakter edukues dhe parandalues;
- Shënime të datave të ndryshme ndërkombëtare (Dita e Tokës, Dita e Ujit, Dita kundër duhanit, Dita kundër HIV-AIDS, Dita kundër substancave narkotike, etj.).
- Zhvillimi i aktiviteve ditore, organizim të kurseve të ndryshme në Qendrën rinore në Vushtrri me karakter të edukimit joformal (kurse të ndryshme, gj. angleze, gj. gjermane, kompjuter, gazetari, pikturë, fotografi, etj.).
- Aktivitetet e ndryshme (Dita e Rinisë)

3. Punësimi dhe ndërmarrësia

Definicioni: Programi bazohet në një tematikë shumë aktuale në Kosovë, fundja është mënyra më e mirë dhe e qasshme për të rinjtë, duke krijuar mundësi avancimi dhe vetëpunësimi në nivel lokal.

Qëllimi: Stimulimi i të rinjve për vetiniciativë në fushën e ndërmarrësisë dhe vetëpunësimit, duke krijuar aftësi të mira sidomos në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.

Objektivat:

- Rritja e interesimit për investimet te të rinjtë, sidomos tek zonat rurale, dhe
- Krijimi i një bashkëpunimi në mes të rinjve dhe bizneseve aktuale në Komunën e Vushtrrisë.

Planifikimi i aktiviteve:

- Takime me të rinj, për rëndësinë e regjistrimit të tyre si të papunësuar;
- Takime me Entin për Punësim në nivel lokal;
- Takime dhe vizita në bizneset më të suksesshme të komunës;
- Ofrim të mbështetjes së tyre rreth zhvillimit të një plani biznesor;
- Trajnim për Hartim të plan-bizneseve,
- Takime informuese në lidhje me grantet/subvencionet qeveritare sidomos në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.

4. Siguria njerëzore

Definicioni: Siguria në një shoqëri, multikulturore, etnike, fizike, gjinore dhe gjuhësore, sigurisht se kërkon edhe një angazhim gjithëshoqëror për të ruajtur dhe promovuar në nivelin më të lartë të saj:

Qëllimi: “Promovimi dhe avancimi i sigurisë në komunë, me theks të veçantë në shkollat e meme të komunës”

Objektivat:

Ngritja e nivelit të sigurisë
Ngritja e bashkëpunimit ndërinstytucional për çështje të sigurisë

Aktivitetet e programit:

- Takime me nxënës të shkollave për çështje të sigurisë;
- Takime me institucione komunale (komitete, këshilla, ekupe, polici, FSK, Kryqi i Kuq, Handikos, etj);
- Avokim për krijimin e hapësirave të qasshme për persona me aftësi të kufizuara;
- Avokim për krasimin e qenve endacakë;
- Fushata për pastrimin e mjedisit;
- Avokim për sigurimin e transportit publik për zonat e thella rurale;
- Avokim për ndriçimin e rrugëve dhe lagjeve.

5. Kultura, sporti dhe rekreacioni

Definicioni: Kultura, sporti dhe rekreacioni, zënë vend të veçantë në aktivitete rinore, andaj si të tilla janë shumë të rëndësishme për t’u zhvilluar në kohën dhe momentin e duhur, në mënyrë që nëpërmjet tyre të arrijmë të promovojmë punën vullnetare dhe të gjitha kapacitetet kulturore, sportive dhe rekreative që posedojnë të rinjtë e Vushtrrisë.

Qëllimi: “Promovimi, zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi i ngjarjeve sportive dhe rekreative në Vushtrri”.

Objektivat:

- Rritja e aktiviteteve kulturore në nivel komunal;
- Krijimi i klubeve kulturore, letrare, teatrale;
- Rritja e mbështetjes financiare të aktiviteteve kulturore në komunë.

Planifikimi i aktiviteteve:

- Vizita me të rinjtë në vende të ndryshme të Kosovës, me pasuri të trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Ligjërata për rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, natyrore;
- Organizimi i manifestimeve të ndryshme kulturore;
- Aktivitete të ndryshme sportive (jokompetente);
- Rregullimi i parqeve;
- Kampingje;
- Trajnimin e ciceronëve të rinj të qytetit;
- Fushata për grumbullim të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore, për të pasuruar Muzeun Etnologjik të Vushtrrisë;
- Organizim i Panairit kulturor;
- Organizim të ekspozitave të ndryshme, pikturë dhe fotografi;
- Punëtori me arte kreative (murale);
- Vendosja e kontakteve me organizatat simotra të vendeve tjera, etj.
- Konkurse për poezi dhe ese me tema të ndryshme;
- Festivali “Java e mërgimtarëve”;
- Promovimi i bashkëjetesës, fetare, etnike dhe gjuhësore


Shtojcë:

Pjesë përbërese e këtij dokumenti janë edhe tabelat me këto emërtime:

1. Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje;
2. Zhvillimi dhe promovimi i edukimit joformal dhe edukimit shëndetësor;
3. Punësimi dhe ndërmarrësia;
4. Siguria njerëzore;
5. Kultura, sporti dhe rekreacioni
6. Shpenzimet totale buxhetore.

Ky Plan i Veprimit Rinor Lokal, hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit

1. Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje

Qëllimi, objektiva, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar-dhjetor 2016												Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qëllimi i përgjithshëm: "Përfaqësimi, fuqizimi dhe përkatja e rinisë në politikat vendimmarrëse dhe integrimin e gjithmbarshëm të rinisë"																		
Objektiva: Krijimi i mundësisë dhe hapësirave për pjesëmarrje në vendimmarrje të të rinjve																		
Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje																		
Aktivitetet:																		
-Strukturimi i K/VRL-së-zgjedhjet e zakonshme sipas Statutit;										X				DKRS/SR	300.00 €	300.00 €		300.00 €
Organizimi i takimeve të rregullta mujore në mes të organizatave rinore në komunë, me pjesëmarrje dhe monitorim të DKRS/Sektorit të rinisë;	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	KVRL,DKRS/SR	600.00 €	600.00 €		600.00 €
-Shpenzime administrative për K/VRL dhe Qendrën rinore;	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	DKRS/SR	1,500.00 €	1,500.00 €		1,500.00 €
Monitorimi i mbledhjeve të asamblesë Komunale, Komitetit për Politikë dhe Financa.	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	DKRS, SR, Donatori	5,000.00 €			5,000.00 €
Totali															7,400.00 €	2,400.00 €	5,000.00 €	7,400.00 €

1.1 Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje

Qëllimi, objektiva, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar-dhjetor 2017										Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qëllimi i përgjithshëm: “Përfaqësimi, fuqizimi dhe përkrahja e rinisë në politikat vendimmarrëse dhe integrimin e gjithmbarshëm të rinisë”																
Objektiva: Krijimi i mundësisë dhe hapësirave për pjesëmarrje në vendimmarrje të të rinjve																
Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje																
Aktivitetet:																
Organizimi i takimeve të rregullta mujore në mes të organizatave rinore në komunë, me pjesëmarrje dhe monitorim të DKRS/Sektorit të rinisë;	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	KVRL,DKRS/SR	600.00 €	600.00 €		600.00 €
-Shpenzime administrative për KVRL dhe Qendrën rinore	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	DKRS/SR	1,500.00 €	1,500.00 €		1,500.00 €
10 Takime me të rinj „Roli i të rinjve në vendimmarrje“		X		X		X		X		X		DKRS/SR	1,000.00 €	1,000.00€		1,000.00 €
Trajnimi i të rinjve „Avokim, lobim dhe informim“								X				DKRS/SR	3,000.00 €	1,500.00 €	1,500.00	3,000.00 €
Monitorimi i mbledhjeve të asamblesë Komunale, Komitetit për Politikë dhe Financa.	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	DKRS,SR,Donatori	5,000.00 €		5,000.00 €	5,000.00
Totali													11,100.00 €	4,600.00 €	6,500.00 €	11,100.00 €

1.2 Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje

Qëllimi, objektiva, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar-dhjetor 2018										Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qëllimi i përgjithshëm: "Përfaqësimi, fuqizimi dhe përkrahja e rinisë në politikat vendimmarrëse dhe integrimin e gjuhëbashkë të rinisë"																
Objektiva: Krijimi i mundësisë dhe hapësirave për pjesëmarrje në vendimmarrje të të rinjve																
Pjesëmarrja e rinisë në vendim-marrje																
Aktivitetet:																
-Strukturimi i K/VRL-së-zgjedhjet e zakonshme sipas Statutit;								X			DKRS/SR	300.00 €	300.00 €			300.00 €
Organizimi i takimeve të rregullta mujore në mes të organizatave rinore në komunë, me pjesëmarrje dhe monitorim të DKRS/Sektorit të rinisë;	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	KVRL,DKRS/SR	600.00 €	600.00 €			600.00 €
-Shpenzime administrative për K/VRL dhe Qendën rinore	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	DKRS/SR	1,500.00 €	1,500.00			1,500.00 €
Hulumtimi i nivelit të pjesëmarrjes në vendimmarrje										X	DKRS/SR	4,000.00	1,500.00	2,500.00 €		4,000.00 €
Monitorimi i mbledhjeve të asamblesë komunale, Komitetit për Politikë dhe Financa.	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	DKRS,SR,Donatori	5,000.00 €		5,000.00 €		5,000.00 €
Totali												11,400.00 €	3,900.00 €	7,500.00 €		11,400.00 €

Periudha kohore: janar 2016 -dhjetor 2018

Fonde nga Komuna Vushtri – 10,900.00

Fonde nga donatorët - 19,000.00

Totali 29,900.00 €

2. Zhvillimi dhe promovimi i Edukimit jo-formal, dhe edukimi shëndetësor

Qelimi, objektiva, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar - dhjetor 2016										Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qelimi i përgjithshëm: Zhvillimi i vetëdijes mes të rinjve lidhur me përgjegjësitë qytetare (edukimi shëndetësor me theks të veçantë në temat për IST, HIV-AIDS, kontracëpsion, parandalimi i sjelljeve devijuese dhe të rrezikshme, trajnimet profesionale, kurse dhe aktivite të tjera edukativo-shëndetësore).																
Objektiva: “Zhvillimi dhe promovimi i edukimit joformal dhe edukimit shëndetësor tek të rinjtë”																
Programi: Edukimi joformal, shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor																
Aktivitetet:																
-Kurse për teknologji inofmrativë, gjithë të huaja;						X	X	X	X	X	DKRS/SR	3,600.00 €	1,800.00 €	1,800.00 €	3,600.00 €	
Aktivite të kështilluese për të rinj			X				X	X			KVRL, DKRS/SR	2,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	2,000.00 €	
Trajnime për të rinjtë, menaxhimi dhe përpilimi i projekteve						X					DKRS/SR, OIQ Anëtare	3,600.00 €	1,500.00 €	2,100.00 €	3,600.00 €	
Totali												9,200.00 €	4,300.00 €	4,900.00 €	9,200.00 €	

2. 1 Zhvillimi dhe promovimi i Edukimit jo-formal, dhe edukimi shëndetësor

Qëllimi, objektiva, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar - dhjetor 2017												Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qëllimi i përgjithshëm: Zhvillimi i vetëdijes mes të rinjve lidhur me përgjegjësitë qytetare (edukimi shëndetësor me theks të veçantë në temat për IST, HIV-AIDS, kontracepsion, parandalimi i sjelljeve devijuese dhe të rrezikshme, trajnimet profesionale, kurse dhe aktivite të tjera edukativo-shëndetësore).																		
Objektiva: “Zhvillimi dhe promovimi i edukimit joformal dhe edukimit shëndetësor tek të rinjtë”																		
Edukimi joformal, shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor																		
Aktivitetet:																		
Trajnime për udhëzime në karrier								X						DKRS/SR	3,600.00 €	1,800.00 €	1,800.00 €	3,600.00 €
Trajnime „Peer to Peer“ edukim			X						X	X				DKRS/SR	2,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	2,000.00 €
Fushata kundër dukrive negative					X						X			DKRS	3,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €	3,000.00 €
Fushata informative për edukim shëndetësor								X						DKRS/SR, OJQ Anëtare	3,600.00 €	1,800.00 €	1,800.00 €	3,600.00 €
Trajnim për ciceron kulturor						X								DKRS/SR	3,500.00 €	2,000.00 €	1,500.00 €	3,500.00 €
Totali															15,700.00 €	8,600.00 €	7,100.00 €	15,700.00 €

2. 2 Zhvillimi dhe promovimi i Edukimit jo-formal dhe edukimi shëndetësor

Qelimi, objektiva, programi dhe aktivitetet	Periudha Kohore Janar-Dhjetor 2018												Monitoruesit	Kostoja	Kommuna	Donatorët	Totali	
Qelimi i përgjithshëm: Zhvillimi i vetëdijes mes të rinjve lidhur me përgjegjësitë qytetare (edukimi shëndetësor me theks te veçante ne temat për IST, HIV-AIDS, kontracëpsion, parandalimi i sjelljeve devijuese dhe të rrezikshme, trajnimet profesionale, kurse dhe aktivitete tjera edukativo-shëndetësore).																		
Objektiva: “Zhvillimi dhe promovimi i edukimit joformal dhe edukimit shëndetësor tek të rinjtë”																		
Edukimi joformal, edukimi dhe promovimi shëndetësor																		
Aktivitetet:																		
Trajnime për menaxhim të OJQ-ve						X								DKRS/SR	3,600.00 €	1,500.00 €	2,100.00 €	3,600.00 €
Trajnime për trajner			X					X	X					DKRS/SR	2,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	2,000.00 €
Fushata kundër dukurive negative					X						X			DKRS	3,000.00 €	1,500.00 €	1,500.00 €	3,000.00 €
Fushata informative për edukim shëndetësor								X						DKRS/SR, OJQ Anëtare	3,600.00 €	1,500.00 €	2,100.00 €	3,600.00 €
Trajnim për planifikim dhe strategji lokale							X							DKRS/SR	3,500.00 €	1,500.00 €	2,000.00 €	3,500.00 €
Totali															15,700.00 €	7,000.00 €	8,700.00 €	15,700.00 €

Edukimi joformal, shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor janar 2016- dhjetor 2018

Fonde nga Kommuna Vushtri – 19,900.00 €

Fonde nga donatorët - 20,700.00 €

Totali 40,600.00 €

3. Punësimi dhe ndërmarrësia

Qëllimi, objektivat, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore												Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali							
	janar	dhjetor	2016																					
<p>Qëllimi i përgjithshëm: Stimulimi i të rinjve për vetiniciativë në fushën e ndërmarrësisë dhe vetpunësimi, duke krijuar aftësi të mira sidomos në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.</p> <p>Objektivat:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Rritja e interesimit për investimet të të rinjtë, sidomos tek zonat rurale, dhe - Krijimi i një bashkëpunimi në mes të rinjve dhe bizneseve aktuale në Komunën e Vushtrisë. 																								
Punësimi dhe ndërmarrësia																								
Aktivitetet:																								
Takim në biznese lokale/aftësim i të rinjve në zanate;			X														DKRS/SR	500.00 €	500.00 €				500.00 €	
Takim me Zyrën komunale të punësimi/analizë e numrit të papunëve në Vushtri;						X												DKRS/SR	1,000.00 €	500.00 €	500.00 €			1,000.00 €
Informimi i të rinjve për regjistrimin e tyre si të papunë, rëndësia dhe avantazhet;									X									DKRS/SR	1,000.00 €	500.00 €	500.00 €			1,000.00 €
Avokim për mbështetje të projekteve për të rinjtë në zonat rurale, bujqësi dhe blegtori;			X															DKRS/SR	3,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €			3,000.00 €
Trajnime „Si të aplikojmë për një vend pune“.				X														DKRS/SR	2,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €			2,000.00 €
Totali																			7,500.00 €	4,500.00 €	3,000.00 €			7,500.00 €

3.2 Punësimi dhe ndërmarrësia

Qëllimi, objektivat, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar - dhjetor 2018										Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qëllimi i përgjithshëm: Stimulimi i të rinjve për vetëiniciativë në fushën e ndërmarrësisë dhe vetpunësimit, duke krijuar aftësi të mira sidomos në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.																
Objektivat: - Rritja e interesimit për investimet te të rinjtë, sidomos tek zonat rurale, dhe - Krijimi i një bashkëpunimi në mes të rinjve dhe bizneseve aktuale në Komunën e Vushtrrisë.																
Punësimi dhe ndërmarrësia																
Aktivitetet:																
Takime me biznese;		X		X		X		X		X			400.00 €	400.00 €		400.00 €
Fushatë për konsumimin e prodhimeve vendore;	X			X		X		X		X		DKRS/SR	1,000.00 €	500.00 €	500.00 €	1,000.00 €
Përgatitja e të rinjve për tregun e punë/zanate;	X							X				DKRS/SR	3,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €	3,000.00 €
Ndërmarrja sociale për punë sezonale.			X									DKRS/SR	3,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €	3,000.00 €
Totali													7,400.00 €	4,900.00 €	2,500.00 €	7,400.00 €

Periudha kohore: janar 2016 - dhjetor 2018
 Fonde nga Komuna Vushtrri – 13,400.00
 Fonde nga donatorët - 9,000.00
 Totali 22,400.00 €

4. Siguria njerëzore

Qëllimi, objektivat, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar-dhjetor 2016										Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali
Qëllimi i përgjithshëm: "Promovimi dhe avancimi i sigurisë në komunë, me theks të veçantë në shkollat e memë të komunës"															
Objektivat: -Ngritja e nivelit të sigurisë; -Ngritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për gëshhtë të sigurisë.															
Programi: Siguria njerëzore															
Aktivitetet:															
Avolim për sigurimin e transportit publik dhe rritjen e patrollave të policisë afër objekteve shkollore;			X								DKRS/SR	300.00 €	300.00 €		300.00 €
Avolim për krasinin e qenve endacakë					X						DKRS/SR	1,500.00 €	1,000.00 €	500.00 €	1,500.00 €
Takime me nxënës për sigurinë në shkolla			X						X		DKRS/SR	2,000.00 €	1,000.00	1,000.00	2,000.00 €
Totali												3,800.00 €	2,300.00 €	1,500.00 €	3,800.00 €

4.1 Siguria njerëzore

Qëllimi, objektivat, programi dhe aktivitetet	Periodha Kohore janar-dhjetor 2017										Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qëllimi i përgjithshëm: "Promovimi dhe avancimi i sigurisë në komunë, me theks të veçantë në shkollat e mame të komunës"																
Objektivat: -Ngritja e nivelit të sigurisë; -Ngritja e bashkëpunimit ndër-institucional për çështje të sigurisë																
Siguria njerëzore																
Aktivitetet:																
Takime me organizatat dhe institucionet për siguri në nivel lokal		X		X		X		X		X		DKRS/SR	300.00 €	300.00 €		300.00 €
Hulumtim për çështje të sigurisë			X									DKRS/SR	1,500.00	1,500.00 €		1,500.00 €
Fushata për pasttrimin e mbledhsit		X		X		X				X		DKRS/SR	3,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €	3,000.00 €
Ligjerata në shkolla për siguri		X								X		DKRS/SR	2,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	2,000.00 €
Totali													6,300.00 €	4,800.00 €	2,000.00 €	6,300.00 €

4.2 Siguria njerëzore

Qelimi, objektivat, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar-dhjetor 2016										Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qelimi i përgjithshëm: "Promovimi dhe avancimi i sigurisë në komunë, me theks të veçantë në shkollat e mëme të komunës"																
Objektivat : -Ngritja e nivelit të sigurisë; -Ngritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për çështje të sigurisë																
Siguria njerëzore																
Aktivitetet:																
Takime me institucione për siguri			X									DKRS/SR	300.00 €	300.00 €		300.00 €
Takime në fshatra për sigurinë		X			X			X				DKRS/SR	1,500.00 €	1,000.00 €	500.00 €	1,500.00 €
Ligjërata në shkollat		X						X				DKRS/SR	3,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €	3,000.00 €
Iniciativa dhe fushata për mbrojtje të mjedisit		X		X				X				DKRS/SR	3,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €	3,000.00 €
Takime/konference për sigurinë në shoqëri									X			DKRS/SR	2,000.00 €	2,000.00 €		2,000.00 €
Totali													9,800.00 €	7,300.00 €	2,500.00 €	9,800.00 €

Periudha kohore janar 2016- dhjetor 2018
 Fonde nga Komuna Vushtri – 14,400.00 €
 Fonde nga donatorët - 6,000.00 €
 Totali 20,400.00 € €

5. Kultura, sporti dhe rekreacioni

Qëllimi, objektivat, programi dhe aktivitetet	Periudha kohore janar - dhjetor 2016												Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qëllimi i përgjithshëm: "Promovimi, zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi i ngjarjeve sportive dhe rekreative në Vushtri Objektivat: - Rritja e aktiviteteve kulturore në nivel komunal; -Krijimi i klubeve kulturore, letrare, teatrale; -Mbështetja financiare e aktiviteteve kulturore në komunë.																		
Kultura, Sporti dhe Rekreacioni																		
Aktivitetet:																		
-Promovim të trashëgimisë kulturore				X						X			DKRS/SR	2,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	2,000.00 €	
Panairi kulturor								X	X				DKRS/SR	3,000.00 €	1,500.00 €	1,500.00 €	3,000.00 €	
Turnire sportive								X			X		DKRS/SR,	1,800.00 €	1,800.00 €		1,800.00 €	
Totali														6,800.00 €	4,300.00 €	2,500.00 €	6,800.00 €	

5.1 Kultura, sporti dhe rekreacioni

Qëllimi, objektivat, programi dhe aktivitetet	Periodha kohore janar - dhjetor 2017										Monitoruesit	Kostoja	Komuna	Donatorët	Totali	
Qëllimi i përgjithshëm: "Promovimi, zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi i ngjarjeve sportive dhe recreative në Vushtri																
Objektivat: -Rritja e aktiviteteve kulturore në nivel komunal; -Krijimi i klubeve kulturore, letrare, teatrale; -Mbështetja financiare e aktiviteteve kulturore në komunë. Kultura, sporti dhe rekreacioni																
Aktivitetet:																
Vizita studimore për trashëgimi kulturore jashtë Komunës së Vushtrisë			X					X			DKRS/SR	3,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €	3,000.00 €	
Stimulimi i klubeve rinore, kulturore, letrare, teatrale				X						X	KVRL,DKRS/SR	3,000.00 €	1,500.00 €	1,500.00 €	3,000.00 €	
Ekspozita			X							X	DKRS/SR,OIQ Anëtare	3,600.00 €	1,800.00 €	1,800.00 €	3,600.00 €	
Panairi kulturor								X	X		DKRS/SR	4,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €	4,000.00 €	
Totali												13,600.00 €	7,300.00 €	6,300.00 €	13,600.00 €	

6. Tabela e shpenzimeve për vitet 2016/2017/2018

Emërtimi	Viti:			Komuna	Donatoret /	Totali:
Pjesëmarrja në vendim-marrje	2016	2017	2018	10,900.00 euro	19,000.00 euro	29,900.00 euro
Edukimi Jo -Formal dhe Shendetesia	2016	2017	2018	19,900.00 euro	20,300.00 euro	40,200.00 euro
Punësimi dhe ndermarrësia	2016	2017	2018	13,400.00 euro	9,000.00 euro	22,400.00 euro
Siguria njerezore	2016	2017	2018	14,400.00 euro	6,000.00 euro	20,400.00 euro
Kultur ,Sport dhe Rekreacion	2016	2017	2018	18,600.00 euro	13,300.00 euro	31,900.00 euro
TOTALI:				77,200.00 euro	67,600.00 euro	144,800.00 euro